



**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i*

*Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers*

---

**RAPORTI VJETOR 2019-2021 I ZBATIMIT TË  
STRATEGJISË KOMBËTARE TË REPUBLIKËS  
SË KOSOVËS PËR PARANDALIMIN DHE  
LUFTIMIN E EKONOMISË JO-FORMALE,  
PASTRIMIN E PARAVE, FINANCIMIN E  
TERRORIZMIT DHE KRIMEVE FINANCIARE  
2019-2023**

**MINISTRIA E FINANCAVE, PUNËS DHE TRANSFEREVE**

Tetor 2021, Prishtinë, Kosovë

## **Lista e shkurtesave**

ATK - Administrata Tatimore e Kosovës

ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës

ARBK - Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë

BB - Banka Botërore

BE - Bashkimi Evropian

BK - Bankat Komerçiale

BPV - Bruto Produkti Vendor

BQK - Banka Qendrore e Kosovës

DK - Dogana e Kosovës

FMN - Fondi Monetar Ndërkombëtar

FT - Financimi i Terrorizmit

MF - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

MPB - Ministria e Punëve të Brendshme

MSH - Ministria e Shëndetësisë

MTI - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

MPMS - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

NjIF - Njësia e Inteligjencës Financiare

PK - Policia e Kosovës

PSH - Prokurori i Shtetit

PP - Pastrimi i Parave

SKZH - Strategjia Kombëtare e Zhvillimit

TAK - Tatimi në të Ardhura të Korporatave

TAP - Tatimi në të Ardhura Personale

TVSH - Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

## **Përmbajtja**

<b>Lista e shkurtesave</b> .....	2
<b>Përmbledhja ekzekutive</b> .....	4
<b>Pasqyra Përmbledhëse</b> .....	5
<b>Tabela 1: Kartela raportuese e zbatimit të Aktiviteteve të SLEJ në 2019-2020</b> .....	7
<b>Objektivi Strategjik I</b> .....	14
<b>Objektivi Specifik I</b> .....	15
Tabela 2: Sfidat dhe Rekomandimet .....	16
<b>Objektivi Specifik I.2</b> .....	16
Tabela 3: Sfidat dhe Rekomandimet .....	17
<b>Objektivi Specifik I.3</b> .....	17
Tabela 4: Sfidat dhe Rekomandimet .....	18
<b>Objektivi Specifik I.4</b> .....	19
Tabela 5: Sfidat dhe Rekomandimet .....	20
<b>Objektivi Strategjik II</b> .....	20
<b>Objektivi Specifik I.2</b> .....	21
Tabela 6: Sfidat dhe Rekomandimet .....	21
<b>Objektivi Specifik II.2</b> .....	21
Tabela 7: Sfidat dhe Rekomandimet .....	22
<b>Objektivi Specifik II.3</b> .....	22
Tabela 8: Sfidat dhe Rekomandimet .....	23

## Përmbledhja ekzekutive

Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023 (tani e tutje SLEJ 2019-2023), ka për qëllim zhvillimin e një sistemi të qëndrueshëm në Kosovë për të luftuar ekonominë joformale, financimin e terrorizmit dhe krimet tjera financiare, për t'u integruar në luftën rajonale dhe ndërkombëtare për të siguruar paqe sociale, mirëqenie, dinjitet, barazi dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në përputhje me politikat e Qeverisë së Republikës së Kosovës (tani e tutje QRK).

Objektivat strategjikë që synohen të arrihen nëpërmjet kësaj strategjie janë; përmirësimi i cilësisë së qeverisjes në ekonomi nëpërmjet identifikimit, analizimit, trajtimit dhe monitorimit të luftimit të ekonomisë joformale, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit si dhe rritja e burimeve financiare për shërbimet publike si rezultat i të hyrave shtesë tatimore dhe nga konfiskimi i pasurisë së paligjshme. Këto dy objektiva janë shprehje e përmirësimit sasior dhe cilësor, të cilat Qeveria i mendon si themeltare për t'u përballur me sfidat dhe problemet e ekonomisë joformale. Po ashtu ato janë edhe një jetësim i angazhimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës në dialogun me Bashkimin Evropian (BE) gjatë vitit 2018, përputhshmëri me dokumentin themeltar Strategjia Kombëtare e Zhvillimit (SKZH) dhe Programin e Reformave Ekonomike 2019-2021 dhe dokumente të tjera strategjike të Kosovës.

Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023 përmbanë në vete dy objektiva strategjikë, shtatë objektiva specifike si dhe 71 aktivitete.

Lidhur me objektivin strategjik I, mund të themi se është arritur të përmbushet vetëm gjysma e asaj çfarë është synuar. Ky objektiv përmbanë në vete 53 aktivitete të cilat janë shpërndarë në katër objektiva specifike. Nga gjithsej pesëdhjetë e tre (53) aktivitete, njëzetë e pesë (25) apo 47% prej tyre janë zbatuar, kurse njëzetë e tetë (28) apo 53% nuk janë zbatuar.

Ngecje është shënuar në arritjen e përmirësimit cilësor të të dhënave për të mundësuar zhvillimin e politikave që në mënyrë të efektshme kontribuojnë në uljen e ekonomisë joformale ku përkundër përmbushjes së disa aktiviteteve, mungesa e progresit në sektorin bankar ka bërë që ky objektiv të mos përmbushet në tërësi. Mungesa e zbatimit të aktiviteteve për vetëdijësimin e qytetarëve si dhe vonesat në përmirësimin e infrastrukturës ligjore ka ndikur që të mos arrihet objektivi specifik i cili synon rritjen cilësore të përmbushjes vullnetare. Progres i konsiderueshëm është arritur në përmirësimin cilësor të kapaciteteve institucionale dhe bashkërendimit për zbatim më të mirë të politikave të miratuara. Përmes bashkëpunimit të institucioneve si MF, ATK, Dogana, Policia e Kosovës, NjIF dhe ASK është arritur përmbushja e shumicës së aktiviteteve në kuadër të këtij objektivi. Përkundër mungesës së numrit të saktë të uljes së punësimit jo-formal në vend, përmes punës së institucioneve, me fokus të veçantë ish-MPMS, është arritur përmbushje e konsiderueshme e aktiviteteve lidhur me këtë objektiv specifik.

Objektivi Strategjik II mund të konsiderohet që është përmbushur në pjesën më të madhe të tij. Ky objektivi përmbanë në vete tre objektiva specifike dhe gjithsej tetëmbëdhjetë (18) aktivitete, prej të cilave dymbëdhjetë (12) apo 66% janë zbatuar, ndërsa gjashtë (6) apo 34% nuk janë zbatuar.

Objektivat specifike në kuadër të këtij objektivi strategjik janë të emërtuar njësoj sikurse ata në kuadër të Objektivit Strategjik I, mirëpo aktivitetet e cilat janë paraparë për t'i përmbushur këto objektiva janë të ndryshme. Njësoj si në kuadër të Objektivit strategjik I, nuk është arritur progres në përmirësimin cilësor të të dhënave ku sfida ka qenë kryerja e vlerësimeve të impaktit të masave qeveritare kundër ekonomisë jo-formale si dhe ndikimi i pandemisë në shtyrjen e studimeve në fushën e ekonomisë joformale sipas standardeve ndërkombëtare.

Po ashtu, vonesa janë shënuar edhe në përmbushjen e aktiviteteve lidhur me përmbushjen vullnetare, ku aktivitetet e parapara për periudhën raportuese janë shtyrë për fundin e vitit 2021.

Ndërsa, progres mjaft i rëndësishëm është arritur me përmbushjen e aktiviteteve të objektivit specifik II.3, ku përmes bashkëpunimit institucional janë arritur një sërë rezultatesh të cilat si synim kanë pasur ngritjen e kapaciteteve njerëzore, luftimin e evazionit fiskal si dhe parandalimin e financimit të terrorizmit dhe shpërlarjes së parave.

## **Pasqyra Përmbledhëse**

Situata pandemike në vend ka ndikuar që fillimi i zbatimit të kësaj strategjie të përballet me sfida të paparashikueshme. Me ndërmarrjen e masave për ta luftuar pandeminë është ndikuar edhe puna e institucioneve zbatuese dhe raportuese të kësaj Strategjie. Si pasojë, ky dokument paraqet raportin e parë të zbatimit të Strategjisë që nga miratimi i saj në fund të tre mujorit të dytë të vitit 2019 dhe përfshinë periudhën raportuese për vitin 2019 dhe 2020.

Raporti vjetor final është përpiluar fillimisht pas përpilimit të tabelës raportuese, e cila është plotësuar me kontributet nga bartësit kryesorë të prioriteteve. Raporti është bazuar në planin e veprimit<sup>1</sup> dhe raporton për përmbushjen e aktiviteteve në kuadër të objektivave strategjike dhe specifike. Procesi i përgatitjes së këtij raporti vjetor ka ndjekur procedurat dhe praktikatat e rregullta që Ministria e Financave, Punes dhe Transfereve (MFPT) i zbaton në bazë vjetore si dhe Udhëzimin Administrativ (QRK) nr. 07/2018. Procesi për përpilimin e këtij raporti ka filluar në fillim të vitit 2021. Sekretariati i SLEJ u takua me 11 shkurt 2021 ku përfaqësuesit e institucioneve përgjegjëse u koordinuan për sigurimin e dokumenteve raportuese për Strategjinë. Si rrjedhojë e kësaj mbledhje, u draftua një draft raport jo-formal i cili kishte karakter orientues për institucionet zbatuese. Përmes komunikimeve në formë elektronike, kontributi i strukturave zbatuese u sigurua deri në fund të tre mujorit të dytë të vitit 2021. Pas lehtësimit të masave kundër pandemisë, me datë 18 Gusht 2021 është mbajtur takimi i fundit i Sekretariatit ku janë ngritur sfidat dhe rekomandimet për raportimin dhe zbatimin e Strategjisë. Kontributet finale për zbatimin e Strategjisë janë përditësuar në fund të tre mujorit të tretë të vitit.


---

<sup>1</sup> Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023 - <https://mf.rks.gov.net/desk/inc/media/DBA6BCC4-B875-4A30-9FDB-C144736597B2.pdf> faqe 35.

Sa i përket progresit të shënuar në zbatimin e Strategjisë, vlenë të theksohet ndikimi i madh që ka pasur ndërrimi i Qeverive si dhe pandemia Covid-19 në realizimin e aktiviteteve të parapara. Këta dy faktorë kanë ndikuar që disa nga aktivitetet të mos shihen më si prioritet për disa nga institucionet zbatuese, ndërsa tek aktivitetet tjera është pamundësuar organizimi i punës për shkak të kapaciteteve njerëzore në punë. Përkundër sfidave me të cilat janë përballur institucionet, raporti konstaton se është arritur një progres i kënaqshëm i zbatimit të Strategjisë.

Nga gjithsej 71 aktivitete të planifikuara, tridhjetë e shtatë (37) apo 52% prej tyre janë zbatuar, ndërsa tridhjetë e katër (34) apo 48% prej tyre nuk janë zbatuar

### **Grafiku 1: Progresi në zbatimin e aktiviteteve të SLEJ për periudhën 2019-2020.**



*Burimi: Strategjia Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-Formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023.*

**Tabela 1: Kartela raportuese e zbatimit të aktiviteteve të SLEJ në 2019-2020**

Aktiviteti	Statusi	Institucioni
<b>OBJEKTIVI STRATEGJIK I: Përmirësimi i cilësisë së qeverisjes në ekonomi nëpërmjet identifikimit, analizimit, trajtimit dhe monitorimit të luftimit të ekonomisë joformale, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit</b>		
<b>Objektivi specifik 1: Përmirësimi cilësor i të dhënave për të mundësuar zhvillimin e politikave që në mënyrë të efektshme kontribuojnë në uljen e ekonomisë joformale.</b>		
1.1.1 Avancimi në përdorimin e të dhënave të anketave statistikore nga ASK (Agjencia për Statistikat e Kosovës) në modelet e vlerësimit të ekonomisë joformale në Kosovë, në parashikimet makro-fiskale të Ministrisë së Financave (MF) dhe masave politike të adresuara në strategji sektoriale	Zbatuar	DPMBNF
1.1.2 Sigurimi i pajtueshmërisë së të dhënave të ASK lidhur me ekonominë joformale në përputhje me metodologjitë dhe standardet ndërkombëtare.	Zbatuar	ASK
1.1.3 Realizimi i anketës për çmimet e tokës bujqësore nga ASK.	Pa zbatuar	ASK
1.1.4 Përgatitja e një udhëzuesi mbi Metodologjinë e Vlerësimit të impaktit të ndryshimeve tatimore ( Tax Expenditure), i cili të zbatohetose praktikohet përpara miratimit të çdo mase fiskale të propozuar.	Zbatuar	DPFTF
1.1.5 Specifikimi në thesar i komponentëve të pagesave nga tatimpaguesit: i) Gjobë, ii) Ndëshkim, iii) Interes, iv) Shmangie tatimore, v) Lloj Tatimi	Pa zbatuar	Thesari i Kosovës (THK) ATK
1.1.6 Rritja e mbikëqyrjes nga BQK (Banka Qendrore e Kosovës) për përshkrimin e transaksioneve financiare nga bankat në mënyrë që të rritet dobia e informacionit për analiza cilësore në organet përkatëse	Pa zbatuar	BQK
1.1.7 Krijimi i një sistemi ndër bankar të pagesave me qëllim të stimulimit të pagesave me kartelë dhe formave të tjera të pagesave duke zvogëluar në masë përdorimin e kesh-it si mjet pagese.	Pa zbatuar	BQK Qeveria e Republikës së Kosovës
1.1.8 Dhënia e Kredive bankare bazuar në pasqyrat financiare të dorëzuara në ATK dhe të certifikuara nga ekspertët e lëmisë për të gjitha bizneset që janë të obliguara të		BQK

dorëzojnë pasqyrat në këtë institucion.	Pa zbatuar	
1.1.9 Publikimi i vazhdueshëm i të dhënave të fushës së financave publike, sipas formatit të të dhënave të hapura, në Portalin Kombëtar për të Dhëna të Hapura.	Pa zbatuar	MAP
1.1.10 Zgjerimi i gamës së Vlerësimeve të Rrezikut nga NJIF (Njësia e Inteligjencës Financiare) duke shtuar vlerësimin e Sektorit Financiar	Zbatuar	NjIF
<b>Objektivi Specifik I.2 Rritja cilësore e përmbushjes vullnetare përmes ngritjes së vetëdijes, raportimit dhe masave ligjore të kufizimit</b>		
1.2.1 Rritja e aktiviteteve të komunikimit me publikun (numrin, pjesëmarrësve dhe buxhetet) për të rritur shkallën e ndërgjegjësimit të qytetarëve nga organet përgjegjëse për zbatimin e kësaj strategjie.	Zbatuar	MF ATK DK MPMS PK
1.2.2 Rritja e numrit të konferencave, punëtorive, takimeve të përbashkëta me shoqatat profesionale për të diskutuar ndikimin e masave të luftës kundër ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare (anëtarësisë së këtyre shoqatave, numri i pjesëmarrësve dhe dokumentet e konferencave).	Zbatuar	MF ATK NJIF MPMS DK PK
1.2.3 Pasqyrimi në raportin vjetor të zbatimit të strategjisë lidhur me të ardhurat nga ekonomia joformale gri dhe e zezë në faqen e internetit të MF.	Pa zbatuar	MF ATK NJIF MPMS DK PK
1.2.4 Përgatitja dhe Publikimi i Fletëpalosjes me informacion për publikun rreth efektit të pritur në parandalimin e ekonomisë joformale nga zbatimi i masave të parapara sipas nenit 64 të MSA mbi sistemet e Pagesave	Pa zbatuar	BQK
1.2.5 Të bëhet një studim lidhur me procesin e vlerësimit të çmimit të pronës, regjistrimit të të patundshmeve në rast blerje për herë të parë apo transferimi në mënyrë që vlera e asetit të regjistruar të pasqyrojë vlerën aktuale të tregut.		Kadastra; MF/ Departamenti i Tatimit mbi Pronën; Komunat;



	Pa zbatuar	BQK; MD.
1.2.6 Të funksionalizohet sistemi i unifikuar i adresave.	Pa zbatuar	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Agjencioni Kadastral i Kosovës; Komunat.
1.2.7 Përgatitja e koncept dokumentit lidhur me dorëzimin e deklaratës vjetore të tatimit mbi të ardhurat personale në ATK edhe nga personat fizik jo afarist.	Pa zbatuar	MF ATK
1.2.8 Përgatitja e koncept dokumentit lidhur me dorëzimin e deklaratës vjetore familjare të tatimit mbi të ardhurat personale në ATK edhe nga personat fizik jo afarist.	Pa zbatuar	MF ATK
1.2.9 Të gjitha pagesat e të punësuarve nga ana e punëdhënësit të bëhen nëpërmjet sistemit bankar	Pa zbatuar	MPMS MF ATK
1.2.10 Rritja e numrit të bizneseve të pajisura me markë fiskale.	Zbatuar	MF ATK
1.2.11 Të implementohet fatura elektronike në sistemin e ri të TI-së në ATK.	Pa zbatuar	MF ATK
1.2.12 Plotësim/ndryshimi i Ligjit për Financimin e Partive Politike dhe nxjerrja e akteve ligjore dhe nënligjore për publikimin dhe transparencën e informacionit të financave të partive politike	Pa zbatuar	KQZ ZKM
1.2.13 Auditimi i pavarur i financave të partive politike dhe publikimi i rezultateve të tyre	Pa zbatuar	Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA)
1.2.14 Themelimi i njësisë për Rikthimin e Aseteve të Konfiskuara.	Pa zbatuar	AMSKA
1.2.15 Krijimi i fondit të konfiskimit në Kosovë.	Pa zbatuar	MD
1.2.16 Fillimi i hetimit financiar që në fillim në raste kur dyshohet për korrupsion e për të cilat PK dhe Prokuroria e Shtetit vlerëson se ka potencial për konfiskim të pasurisë të fituar me vepra penale në përputhje me rekomandimet e FATF-së.		PK; Prokuroria e Shtetit

	Zbatuar	
1.2.17 Shtimi i aktiviteteve hetimore për veprat penale kundër ekonomisë siç është e përcaktuar në Kodin Penal të Kosovës (Kapitulli XXV)	Zbatuar	PK; Prokurori; DK; ATK.
1.2.18 Aprovimi i Koncept dokumentit për përmirësimin e legjislacionit në fushën e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit, në përputhje me praktikën e BE-së, rekomandimet e PECK II, Raportit të Vëndit 2018 për Kosovën dhe MSA (Neni 89) .	Pa zbatuar	MF; NJIF.
1.2.19 Rritja e numrit të vizitave dhe kontrolleve të realizuara bazuar në vlerësimin e rrezikut në luftimin e ekonomisë joformale, evazionit tatimor dhe shmangies tatimore.	Zbatuar	ATK
1.2.20 Plotësim ndryshimi i Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat.	Pa zbatuar	MF; ATK
<b>Objektivi Specifik I.3: Përmirësimi cilësor i kapaciteteve institucionale dhe bashkërendimit për zbatim më të mirë të politikave të miratuara.</b>		
1.3.1 Përditësimi i vazhdueshëm i klasifikimit të aktivitetit ekonomik të bizneseve sipas nomenklaturës ndërkombëtare (NACE rev.2) dhe shkëmbimi i këtyre informacioneve në mes të ARKBK-së, ATK-së dhe ASK-së.	Zbatuar	ARBK; ATK; ASK.
1.3.2 Intensifikimi dhe bashkërendimi i aktiviteteve në mes ATK dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) me qëllim identifikimin dhe regjistrimin e punëtorëve të pa regjistruar, duke u bazuar në të dhënat e marra nga Agjencia e Statistikave të Kosovës në publikimin e anketave të ekonomisë joformale.	Zbatuar	MPMS; ATK
1.3.3 Arritja e një memorandumi të mirëkuptimit midis Ministrisë së Drejtësisë dhe MF/ATK për të siguruar shkëmbimin e të dhënave nganterët për transaksionet i) Në patundshmëri ii) Makina iii) Qira, i cili si minimum të ofrojë informacion mbi numrin e transaksioneve, tipin (blerje, transferim, qira), adresën, vlerën, subjektin (person fizik, biznes apo publik).	Pa zbatuar	MD; MF; ATK.

1.3.4 Zhvillimi dhe prezantimi i moduleve të reja të programeve fiskale për të përmirësuar parashikimet fiskale për të ardhurat në sektorë.	Pa zbatuar	MF
1.3.5 Publikimi dhe përditësimi i listës së High Risk Countries (sipas publikimeve të FATF), Lista e Zezë EU, OECD Lista e GoldPassports 2018 etj.	Zbatuar	NjIF
1.3.6 Rishikimi i metodologjisë së vlerësimit të Rrezikut NJIF sipas rekomandimeve të vlerësimeve dhe asistencës teknike në këtë fushë.	Zbatuar	NjIF
1.3.7 Rritja e veprimeve të koordinuara (kontroll/inspektim) të NJIF dhe organeve të zbatimit të ligjit në bizneset me rrezik të lartë, pjesë e listës së identifikuar nga NJIF.	Zbatuar	NJIF; PK; ATK; DK;
1.3.8 Rritja e inspektimeve dhe aktiviteteve të mbikëqyrjes së pajtueshmërisë në zyrat noteriale dhe agjencitë e paluajtshmërive, përtë vlerësuar pajtueshmërinë e subjekteve raportuese me Ligjin për PPP dhe FT.	Zbatuar	NjIF
1.3.9 Të sigurohet bashkëpunimi funksional nga Administrata Tatimore dhe Dogana e Kosovës me Administratat e huaja tatimore dhe Doganore përmes nënshkrimit të MM-ve, për forcimin e shkëmbimeve ndërkombëtare të informacionit e veçanërisht lidhur me kompaninë amë apo kompaninë e linjës	Zbatuar	MF; ATK; DK.
1.3.10 Të rritet cilësia e monitorimit dhe procedurave penale të ndërtimit për të zvogëluar ndërtimin e kundërligjshëm dhe ndërtimin e ndërtesave që nuk i përmbushin specifikacionet e kërkuara.	Zbatuar	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH); MF/Departamenti i Tatimit në Prone; Komunitat
1.3.11 Trajnimi dhe rritja e kapaciteteve në Divizionin e Ekonomisë joformale dhe llogarive qeveritare.	Zbatuar	ASK
1.3.12 Trajnimi për "Forecast consolidation" të Divizionit të Politikave Fiskale për "Tax Expenditures and Impact Assessment".	Pa zbatuar	MF
<b>Objektivi Specifik I. 4: Zvogëlimi i punësimit joformal në Kosovë</b>		

1.4.1 Organizimi i fushatave informuese përpublikun dhe punëdhënësit	Zbatuar	MPMS; ATK; MTI; MF; Partnerët Social
1.4.2 Angazhimi i palëve të interesit dhe publikuttë gjerë në adresimin e punësimit joformal	Zbatuar	MPMS, MF, MTI, ATK, TRUSTI, KES
1.4.3 Analiza e gjendjes dhe vlerësimi i praktikavetë mira për zvogëlimin e punës joformale.	Zbatuar	MPMS; Ministritë e Linjës Partnerët social
1.4.4 Realizimi i një analize lidhur me krijimin eregjistrit të të punësuarve në kuadër të MPMS	Zbatuar	MPMS, ATK, APRK, Trusti
1.4.5 Përgatitja e udhëzuesit për metodologjinë e vlerësimit të shkallës së rrezikshmërisë së rasteve/prioritizimi dhe vendosja e planit të inspektimit; dhe trajnimi i stafit përkatës për përdorimin e metodologjisë	Pa zbatuar	MPMS; ATK
1.4.6 Zhvillimi i manualit/procedurat e veprimitpër inspektimin.	Zbatuar	MPMS; ATK
1.4.7 Ndërtimi i një sistemi monitorues dhe sistemi për vlerësimin e performancës sëpunës së inspektorëve	Pa zbatuar	MPMS; ATK
1.4.8 Trajnime për ngritjen e kapaciteteve tëinspektorëve	Pa zbatuar	MPMS
1.4.9 Funksonalizimi/ndërtimi i Sistemit tëMenaxhimit të Informatave	Pa zbatuar	MPMS
1.4.10 Pajisja e inspektorëve me mjete pune	Zbatuar	MPMS
1.4.11 Pajisja e inspektorëve me vetura	Zbatuar	MPMS
<b>OBJEKTIVI STRATEGJIK II: Rritja e burimeve financiare për shërbimet publike si rezultat i të hyrave shtesë tatimore dhe nga konfiskimi i pasurisë së paligjshme.</b>		
<b>Objektivi specifik II.1: Përmirësimi sasior i të dhënave për të mundësuar zhvillimin e politikave që në mënyrë të efektshme kontribuojnë në uljen e ekonomisë joformale.</b>		

2.1.1 Kryerja e vlerësimeve të impaktit të masave të politikave të publikuara nga administrata e Kosovës me objektiv ekonominë joformale (Impact Assessments)	Pa zbatuar	MF
2.1.2 Kryerja e studimeve apo vlerësimeve nëfushën e ekonomisë joformale sipas standardeve ndërkombëtare lidhur me hendekun tatimor.	Pa zbatuar	MF; ATK; MPMS; ASK
<b>Objektivi Specifik II.2: Rritja sasiore e përmbushjes vullnetare përmes ngritjes së vetëdijes, raportimit dhe masave ligjore të kufizimit.</b>		
2.2.1 Ulja e pragut lidhur me transaksionet në mes bizneseve të cilat bëhen në kesh (aktualisht 500 EUR).	Pa zbatuar	MF ATK
2.2.2 Dizajnimi i Softuerit për arkat fiskale për të dhënë informata lidhur me: numrin e kuponëve fiskal të lëshuar, kohën dhe artikujt- të gjitha këto në kohë reale (online)	Pa zbatuar	ATK
<b>Objektivi Specifik II.3: Përmirësimi sasior i kapaciteteve institucionale dhe bashkërendimit për zbatim më të mirë të politikave të miratuara.</b>		
2.3.1 Rishikimi i formave standarde për shkëmbim të dhënave elektronike dhe në bartës fizik me qëllim shkurtimin e kohës së rrjedhës së informacionit në komunikimin ndër institucional dhe ndërkombëtar.	Zbatuar	MAP; MD; PK; ATK; DK; NJIF
2.3.2 Publikimi i tabelës Burime/Përdorimi nga ASK.	Pa zbatuar	ASK
2.3.3 Përmirësimi i kapaciteteve të parashikimeve fiskale për të ardhurat nëpër sektorë përmes instalimit të moduleve të reja krahas modelit të programimit fiskal.	Pa zbatuar	MF
2.3.4 Zgjerimi i inspektimeve në sektorin e ndërtimitarisë dhe OJQ-ve, lidhur me FT (Financimi i Terrorizmit ) dhe PP (Pastrimi i Parave), ku inspektimet tek subjektet e caktuara që paraqesin rrezik më të lartë, të bazohen në inteligjencën financiare, tatimore dhe kriminale (Target të jetë sektori i ndërtimitarisë).	Zbatuar	NJIF ATK PK
2.3.5 Krijimi i grupeve të përbashkëta DK dhe ATK me qëllim kontrollin e mallrave që kategorizohen me rrezik të lartë të shmangies së taksave.	Zbatuar	DK; ATK
2.3.6 Hetimi dhe realizimi i operacioneve të përbashkëta me qëllim luftimin e kontrabandës së mallrave.	Zbatuar	PK; DK; Prokuroria

2.3.7 Rritja e aktiviteteve të ndërmarra ne parandalimin e mallrave që shkelin të drejtëne pronësisë Intelektuale – IPR	Zbatuar	DK
2.3.8 Rritja e numrit të patrullimeve të njësiteve anti kontrabandë me qëllim luftimin e kontrabandës .	Zbatuar	DK
2.3.9 Aplikimi i kontroleve pas importuese nëbazë të menaxhimit të rrezikut dhe informacioneve tjera.	Zbatuar	DK
2.3.10 Trajnime për ATK-në në fushën e menaxhimit të rrezikut	Zbatuar	ATK
2.3.11 Trajnim për Doganat e Kosovës në fushën e zbatimit të Ligjit	Zbatuar	DK
2.3.12 Trajnime të dedikuara profesionalizmi të Prokurorëve për veprën penale të krimit ekonomik dhe pastrimin e parave.	Zbatuar	Prokuroria
2.3.13 Organizimi i trajnimeve për institucionet që monitorojnë aktivitetet në sektorin e ndërtimtarisë mbi PP/FT, lidhur me parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimet tjera financiare, posaçërisht në sektorin e ndërtimtarisë dhe patundshmërive(auditorët dhe inspektorët)	Zbatuar	NjIF
2.3.14 Ngritja e aftësive profesionale në fushën ePP/FT per Prokuroret, Gjyqtaret, Hetuesit,dhe Inteligenca Financiare.	Zbatuar	NJIF; PK; MD; Prokuroria;


## Objektivi Strategjik I

Ky objektivi synon përmirësimin e cilësisë së qeverisjes në ekonomi nëpërmjet identifikimit, analizimit, trajtimit dhe monitorimit të luftimit të ekonomisë joformale, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Përmes masave të këtij objektivi synohet të bëhet korigjimi i problemit të dëmtimit të cilësisë së qeverisjes ekonomike për shkak të ekonomisë joformale të shprehur si prani e konkurrencës së padrejtë, pabarazisë, moszbatimit të kontratave, prani e artikujve të kontrabandës dhe punësimit joformal me të drejta të pakta të të punësuarve.

Në kuadër të këtij objektivi ishin planifikuar gjithsej 53 aktivitete, nga të cilat njëzetë e pesë (25) apo 47% prej tyre janë zbatuar, kurse njëzetë e tetë (28) apo 53% prej tyre nuk janë zbatuar

Aktivitetet në kuadër të këtij objektivi janë të ndara në katër objektiva specifike.

Grafiku 2: Zbatimi i aktiviteteve te Objektivit Strategjik I



*Burimi: Strategjia Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-Formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023.*

**Në objektivin specifik I** është synuar përmirësimi cilësor i të dhënave për të mundësuar zhvillimin e politikave që në mënyrë të efektshme kontribuojnë në uljen e ekonomisë joformale.

Gjatë periudhës raportuese janë paraparë gjithsej dhjetë (10) aktivitete, katër (4) apo 40% prej të cilëve janë realizuar, ndërsa gjashtë (6) apo 60% e tyre nuk janë realizuar.

Aktualisht, MFPT pasqyron ekonominë e Kosovës në kuadër të llogarive kombëtare dhe si i tillë, përfshin ekonominë formale dhe joformale. Të dhënat e anketave statistikore të ASK-së përdoren nga Departamenti i Makroekonomisë në mënyrë që të pasurojnë modelin aktual apo që të mbështesin gjykimin që përdoret në parashikimet makrofiskale.

Po ashtu, ASK ka vazhduar me përpilimin e të dhënave për ekonominë joformale në harmoni të plotë me metodologjinë dhe standardet ndërkombëtare të Eurostatit dhe OECD-së. Ndërsa, për shkak të pandemisë dhe mungesës së stafit nuk është realizuar ndonjë aktivitet konkret lidhur me realizimin e anketës për çmimet e tokës bujqësore nga ASK.

Progres është arritur në kuadër të Metodologjisë së Vlerësimit të impaktit të ndryshimeve tatimore (Tax Expenditure), për të cilën është përgatitur udhëzuesi i cili do të zbatohet ose praktikohet përpara miratimit të çdo mase fiskale të propozuar.

Është aprovuar udhëzimi për përdorimin e formularit mbi prejardhjen e fondeve dhe përcaktimin e mbajtësit të së drejtës së pronësisë, ku është përcaktuar procedura për cilat transaksione zbatohet si dhe mënyra e përdorimit të formularit. Me qëllim të zvogëlimit të konsiderueshëm të përdorimit të cash-it si mjet pagese, Banka Botrore ka përgatitur një draft të studimit të fizibilitetit, mirëpo për ky projekt ka hasur në pengesa të ndryshme të realizimit andaj gjendet ende në proces.

Për shkak të ndikimit të pandemisë janë shtyer për fundin e vitit 2021 ndryshimet rregullative të cilat do të mundësonin dhënien e kredive bankare bazuar në pasqyrat financiare të dorëzuara në ATK dhe të certifikuara nga ekspertët e lëmisë, për të gjitha bizneset që janë të obliguara të

dorëzojnë pasqyrat në këtë institucion. Ndërsa nuk është raportuar progres në publikimin e të dhënave të fushës së financave publike në Portalin Kombëtar për të Dhëna të Hapura.

Njësia e Inteligjencës Financiare (NjIF) ka shënuar progres në zgjerimin e gamës së vlerësimit të rrezikut duke përfshirë aspektin financiar në Vlerësimin e Rrezikut Kombëtar (NRA) të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

**Tabela 2: Sfidat dhe Rekomandimet**

Sfidat	Rekomandimet
Pengesat e pandemisë në realizimin e aktiviteteve të parapara	Ri-planifikimi i aktiviteteve dhe realizimi i tyre në afatet e shtyera.

**Në objektivin specifik I.2** është synuar rritja cilësore e përbushjes vullnetare përmes ngritjes së vetëdijes, raportimit dhe masave ligjore të kufizimit.

Gjatë periudhës raportuese janë paraparë gjithsej njëzetë (20) aktivitete, gjashtë (6) apo 30% prej të cilave janë realizuar, ndërsa katërbëdhjetë (14) apo 70% e tyre nuk janë realizuar.

Institucionet përkatëse kanë vazhduar me vetëdijësimin e publikut rreth luftimit të ekonomisë jo-formale duke shfrytëzuar platformat sociale si dhe kampanjat e ndryshme për të arritur qëllimin që parasheh kjo Strategji. Po ashtu, në kuadër të bashkëpunimit në mes të institucioneve relevante është rritur numri i konferencave, punëtorive dhe takimeve të përbashkëta me shoqatat profesionale me qëllim diskutimin e ndikimit të masave kundër ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare.

Për arsye se ky është raporti i parë i hartuar lidhur me zbatimin e kësaj Strategjie, deri më tani nuk ka pasur ndonjë publikim të përbushjes së objektivave që dalin nga kjo Strategji. Po ashtu, ngecje ka pasur edhe në publikimin e raporteve të ndikimit të masave të parapara sipas nenit 64 të MSA mbi Sistemet e Pagesave. Progresi ka munguar edhe në studimin e procesit të vlerësimit të çmimit të pronës, regjistrimit të patundshmërive në rast blerje për herë të parë apo transferimi në mënyrë që vlera e asetit të regjistruar të pasqyrojë vlerën aktuale të tregut. Ndërsa, projekti i unifikimit të adresave planifikohet të përfundojë në vitin e fundit të kësaj Strategjie. Në kuadër të infrastrukturës ligjore, janë formuar grupet punuese për hartimin e koncept dokumenteve të cilat si synim kanë dorëzimin e deklaratës vjetore personale dhe familjare në ATK edhe nga personat fizikë jo afarist, mirëpo për shkak të pandemisë ende nuk është përfunduar puna në këtë drejtim.

Sfidë për luftimin e ekonomisë jo-formale mbetet pagesa e të punësuarve përmes bankës. Në këtë drejtim, puna e pa-deklaruar vazhdon të jetë faktori kyq në mos-realizimin e plotë të këtij qëllimi. Në anën tjetër, është vazhduar me pajisjen e bizneseve me arkë fiskale, ku numri i bizneseve që posedojnë arka fiskale është gjithnjë në rritje. Po ashtu, ATK vazhdimisht monitoron edhe lëshimin e kuponëve fiskal nga bizneset. Ndërkaq, është dizajnuar moduli i sistemit për përkrahjen e faturës elektronike. Zhvillimi i këtij moduli pritet të përfundojë në fund të vitit 2021, ndërsa implementimi i tij dhe ndërlidhja/qasja nga ana e tatimpaguesve do të realizohet në fillim të vitit 2022. Lidhur me plotësim/ndryshimin e Ligjit për Financimin e Partive Politike nuk është shënuar progres, dhe si pasojë nuk është arritur realizimi i këtij aktiviteti.

Themelimi i Agjencisë për Rikthimin e Aseteve të Konfiskuara nuk është më në planin e Ministrisë së Drejtësisë për shkak se një njësi e tillë për rikthim të aseteve veçse ekziston brenda



Policisë së Kosovës. Ndërsa, lidhur me fondin e konfiskimit, Ministria e Drejtësisë ka themeluar një grup punues për hartimin e një Koncept Dokumentit, i cili ka për qëllim të mundësohet krijimi i infrastrukturës së përgjithshme ligjore për përdorimin e pasurive të konfiskuara, nëpërmes themelimit të një fondi të konfiskimit nga institucionet që merren me zbatimin e ligjit dhe ri-përdorimit social të tij. Aktualisht, grupi ka hartuar një draft të këtij KD i cili tashmë është edhe pjesë e Planit të Punës për vitin 2021.

Përgjatë periudhës raportuese, Prokuroria e Shtetit dhe Policia kanë zhvilluar hetime në fushën e krimeve financiare të cilat kanë rezultuar në ngritjen e aktakuzave si dhe konfiskimin e pasurisë të fituar me vepër penale në përputhje me rekomandimet e FATF-së. Po ashtu, përmes bashkëpunimit të këtyre dy institucioneve me Doganën e Kosovës dhe ATK-në është shtuar numri i aktiviteteve hetimore për veprat penale kundër ekonomisë ashtu siç është e përcaktuar në Kodin Penal të Kosovës. Po ashtu, ATK ka rritur numrin e vizitave dhe të kontrolleve bazuar në vlerësimet e rrezikut, ku pothuajse pjesa më e madhe e kontrolleve në ATK caktohen bazuar në vlerësimet e rreziqeve. Fokusi në sektor të caktuar është një qasje e re që ATK tashmë është duke ndjekur. Ndërsa, janë bërë të gjitha plotësim-ndryshimet për Ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat mirëpo i njëjti nuk është aprovuar ende nga Kuvendi.

**Tabela 3: Sfidat dhe Rekomandimet**

<b>Sfidat</b>	<b>Rekomandimet</b>
Dërgimi i raporteve nga ana e institucioneve	Bashkëpunimi dhe koordinimi më i ngushtë mes institucioneve.
Informimi i publikut rreth efektit të luftimit të ekonomisë jo-formale	Publikimi i fletëpalosjeve me informacione rreth ndikimit të luftës ndaj ekonomisë jo-formale.
Ndikimi i pandemisë në përmbushjen e prioriteteve legislative për shkak të punës me staf esencial	Finalizimi i koncept-dokumenteve dhe ligjeve të parapara.
Pagesa e të gjithë punëtorëve përmes sistemit bankar	Luftimi i punës së pa-deklaruar e cila mundëson pagesën e punëtorëve në mënyra tjera nga ajo bankare.

**Në objektivin specifik I.3** është synuar përmirësimi cilësor i kapaciteteve institucionale dhe bashkërendimi për zbatim më të mirë të politikave të miratuara.

Gjatë periudhës raportuese janë paraparë gjithsej dymbëdhjetë (12) aktivitete, tetë (8) apo 66% prej të cilave janë realizuar, ndërsa katër (4) apo 34% e tyre nuk janë realizuar.

Gjatë periudhës raportuese është bërë përditësimi i vazhdueshëm i klasifikimit të aktivitetit ekonomik të bizneseve sipas nomenklaturës ndërkombëtare (NACE rev.2) dhe shkëmbimi i këtyre informacioneve në mes të ARKBK-së, ATK-së dhe ASK-së. Vlenë të theksohet se NACE rev.2 janë të publikuara në faqen e ARBK-së, ku secili biznes/individ ka qasje të plotë në të dhe

mund të informohet me veprimtaritë e bizneseve sipas kodeve. Po ashtu, tatimpaguesi, i cili shfrytëzon Sistemin EDI të ATK-së e ka kusht që për të vazhduar punën më tutje në këtë sistem, duhet paraprakisht të plotësoj tabelën me informata, gjegjësisht të përditësoj të dhënat e tij dhe të konfirmoj se ato të dhëna janë të sakta dhe të vërteta. Një ndër informatat e kërkuara për përditësim është edhe Kodi i veprimtarisë sipas Nace Rev.2

Përmes bashkëpunimit në mes të ish-MPMS, ATK dhe ASK është mundësuar identifikimi dhe regjistrimi i punëtorëve të pa-punësuar, ku gjatë periudhës raportuese janë regjistruar 2,275 punëtor. Po ashtu, ende nuk janë prezantuar module të reja të programeve fiskale të cilat do të mund të pasuronin modelin aktual të parashikimeve fiskale sipas sektorëve. Megjithatë, modeli aktual që përdoret për parashikime fiskale përfshin indikatorë të mjaftueshëm për të parashikuar të dhënat fiskale me një konsistencë të lartë me ato të realizuara vit më vit. Ndërsa ende nuk është arritur të lidhet bashkëpunimi mes MFPT dhe MD për shkëmbimin e të dhënave me noterët, me qëllim të ofrimit të informacioneve për transaksione të dyshimta.

Në kuadër të aktiviteteve të NJIF-K, është publikuar lista e përditësuar e juridiksioneve me rrezikshmëri të lartë dhe atyre nën monitorim të publikuar nga FATF. Po ashtu, ky institucion ka publikuar listën e personave, grupeve dhe subjekteve të shpallura të rrezikshme nga BE. Përveç kësaj, është rishikuar metodologjia e Vlerësimit të Rrezikut Kombëtar për PP/FT (NRA). Metodologjia do të rishikohet përsëri në vitin 2022 gjatë vlerësimit të ardhshëm. Po ashtu, përmes bashkëpunimit të NJIF-K dhe organeve të zbatimit të ligjit, në vitin 2020 janë kryer 31 inspektime tek sektorët më të cënueshëm duke shënuar ngritje prej 24% më tepër se në vitin 2019 (25 inspektime). Disa nga këto inspektime janë kryer në koordinim edhe me BQK.

Për të vlerësuar pajtueshmërinë e subjekteve raportuese me Ligjin për PPP dhe FT, në periudhën 2019-2020, NJIF ka kryer 17 inspektime tek Noterët. Ndërsa, ATK dhe Dogana kanë vazhduar bashkëpunimin e tyre të ngushtë me Administratat e huaja tatimore dhe Doganore duke nënshkruar 26 memorandume të mirëkuptimit me shumicën e vendeve fqinje dhe vende të tjera mike, për shkëmbimin e informatave në bazë të nevojës. Ndërsa, me qëllim të luftimit të ndërtimeve të kundërligjshme, janë lëshuar 20 vendime për ndërprerje të punimeve dhe rrënim si dhe 9 kallxime penale për pa rregullsit e konstatuara ndërtim pa leje. Mirëpo, ende nuk është përmirësuar metodologjia e kontrollit dhe monitorimit.

Në anën tjetër, ASK ka vazhduar me ngritjen e kapaciteteve të stafit, duke siguruar trajnime të vazhdueshme për vlerësimin e ekonomisë jo-formale, ani pse pjesëmarrja në këto trajnime ka qenë e reduktuar për shkak të pandemisë. Pandemia po ashtu ka pamundësuar mbajtjen e trajnimeve në sektorin e politikave fiskale në MFPT.

**Tabela 4: Sfidat dhe Rekomandimet**

Sfidat	Rekomandimet
Vazhdueshmëria e projekteve të parapara në Qeveritë e kaluara	Planifikimi më i mire afatgjatë

Ngritja e kapaciteteve humane për shkak të pandemisë	Mbajtja e trajnimeve të parapara në forma tjera përveç asaj fizike
--	--

**Në objektivin specifik I.4** është synuar zvogëlimi i punësimit joformal në Kosovë. Aktivitetet e parapara në kuadër të këtij objektivi janë të natyrës vetëdijuese për publikun dhe përmirësimit të kushteve të punës për organet zbatuese.

Gjatë periudhës raportuese janë paraparë gjithsej njëmbëdhjetë (11) aktivitete, shtatë (7) apo 63% prej të cilave janë realizuar, ndërsa katër (4) apo 37% e tyre nuk janë realizuar.

Gjatë vitit 2020 janë mbajtur 10 seminare me tatimpagues, përmes të cilave, tatimpaguesit janë informuar për zbatimin e drejtë të Legjislacionit tatimor, si dhe kryerjen e detyrimeve saktë dhe në kohë. Po ashtu, është finalizuar pakoja informative për obligimet tatimore për të gjithë regjistruarit e rinj, dhe si e tillë kjo pako informative është përkthyer edhe në gjuhën serbe dhe angleze. Përmes këtyre marrëdhënieve synohet të rritet përmbushja vullnetare në kohë.

Në anën tjetër, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në bashkëpunim me Inspektoratin e Punës, Administratën Tatimore të Kosovës, Ministrinë e Bujqësisë dhe partnerët tjerë kanë përgatitur konceptin e fushatës së parë informuese me fokus në ngritjen e vetëdijes së punëtorëve dhe kompanive për dobitë e punës së deklaruar. Fushata “Fito. Deklaro. Përfito“ është bazuar në idenë e fushatës së mediave sociale në mbarë BE-në që është udhëhequr nga Komisioni Evropian dhe që është zbatuar në Shtetet Anëtare të BE-së në vitin 2020.

Në kuadër të angazhimit të palëve të interesit dhe publikut të gjerë në adresimin e punësimit joformal, në vitin 2019 janë zhvilluar takimet e Komiteteve Drejtuese të projektit të BE-së “Support to Labour Inspectorate for Fighting against Undeclared Work” ku janë konkretizuar veprimet që institucionet duhen të ndërmarrin në adresimin e punës së padeklaruar. Po ashtu, është hartuar raporti mbi analizën e situatës dhe vlerësimin mbi praktikën më të mira fizibile të Kosovës në reduktimin e punësimit të pa deklaruar (gjashtë nën raporte- analiza), dhe i njëjti është publikuar. Po ashtu, në kuadër të këtij raporti është përgatitur edhe analiza lidhur me krijimin e regjistrit të të punësuarve në Kosovë. Ndërkaq, është hartuar Manuali mbi Procedurat e Inspektimit dhe është dorëzuar tek Inspektorati i Punës. Për shkak të ndikimit të pandemisë, Raporti i Analizës së Procedurave të Inspektoratit të Punës për Zbulimin dhe Parandalimin e Punës së Padeklaruar ende nuk ka përfunduar, mirëpo i njëjti është në zhvillim e sipër.

Vlerësimi i performancës së Inspektoriatit Policorë është kërkesë ligjore sipas Ligjit në fuqi për Organizimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura. Megjithatë, implementimi i saj ka hasur në vonesa për shkak të ndryshimit të legjislaturave në gjatë periudhës raportuese. Ndërsa, trajnimet për ngritjen e kapaciteteve të inspektorëve janë paraparë që të mbahen me asistencë nga Bashkimi Evropian, mirëpo për shkak të ndikimit të pandemisë dhe angazhimit shtesë të inspektoriatit të punës, këto aktivitete janë shtyrë për vitin 2021. Vonesa janë shënuar gjithashtu në procesin e funksionalizimit të Sistemit të Menaxhimit të Informatave, ku i njëjti

gjendet ende në fazën e konsultimit mes Inspektoratit të Punës dhe projektit të UNOPS.-it. Ndërkaq, në kuadër të fasilitimit të punës në terren, janë përmbushur kërkesat për pajisjen e inspektorëve me mjete pune personale si dhe me vetura.

**Tabela 5: Sfidat dhe Rekomandimet**

<b>Sfidat</b>	<b>Rekomandimet</b>
Ndikimi i pandemisë në përgatitjen e udhëzuesit për metodologjinë e vlerësimit të shkallës së rrezikshmërisë së rasteve si dhe trajnimi i stafit përkatës për përdorimin e metodologjisë	Ngritja e kapaciteteve humane bazuar në udhëzuesin e hartuar.
Ndërtimi i sistemit monitorues për punën e inspektorëve	Krijimi i njësisë për vlerësimin e performancës
Ndërtimi i Sistemit të Menaxhimit të Informatave	Finalizimi i projektit përmes bashkëpunimit me UNOPS


## **Objektivi Strategjik II**

Ky objektivi synon rritjen e burimeve financiare për shërbimet publike si rezultat i të hyrave shtesë tatimore dhe nga konfiskimi i pasurisë së paligjshme. Rrjedhojë direkte e ekonomisë joformale është pakësimi i të hyrave nga tatimet në buxhetin e Kosovës dhe ekzistenca e pasurive të paligjshme private. Të dyja këto pasoja ndikojnë në sasinë e burimeve të përdorura për shërbimet publike dhe po ashtu rrisin shkallën e pabarazisë dhe të padrejtësive që kanë ndikim negativ për stabilitetin dhe harmoninë e brendshme të shoqërisë Kosovare. Objektivi është pra që nëpërmjet masave dhe aktiviteteve të marra në Strategji këto dukuri në terma sasiore të pakësohen.

Në kuadër të këtij objektivi ishin planifikuar gjithsej tetëmbëdhjetë (18) aktivitete, nga të cilat dymbëdhjetë (12) apo 66% prej tyre janë zbatuar, kurse gjashtë (6) apo 34% prej tyre nuk janë zbatuar.

Aktivitetet në kuadër të këtij objektivi janë të ndara në tre objektiva specifikë.

Grafiku 3: Zbatimi i aktiviteteve ne kuadër te Objektivit Strategjik II.



*Burimi: Strategjia Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-Formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023.*

**Në objektivin specifik I.2** është synuar përmirësimi sasior i të dhënave për të mundësuar zhvillimin e politikave që në mënyrë të efektshme kontribuojnë në uljen e ekonomisë joformale.

Gjatë periudhës raportuese janë paraparë gjithsej dy (2) aktivitete, të cilat nuk janë realizuar.

Gjatë periudhës raportuese nuk ka pasur progres në kryerjen e vlerësimeve të impaktit të masave të politikave të publikuara nga administrata e Kosovës me objektiv ekonominë joformale (impact assessments). Ndërsa, Në kuadër të IPA Multi Beneficiary Project 2017 “Metodologjia e Llogarive Kombëtare”, ASK ka filluar me vlerësimin e ekonomisë informale bazuar në kontrollat e auditimit fiskal, ku do të matet vlera e tatimeve shtesë që bizneset kanë paguar pas kontrollave të ATK-së dhe shqiptimit të ndëshkimeve. Të dhënat do të përpilohen sipas aktiviteteve ekonomike të NACE Rev.2.

**Tabela 6: Sfidat dhe Rekomandimet**

Sfidat	Rekomandimet
Kryerja e vlerësimeve të impaktit të masave të politikave të publikuara nga administrata e Kosovës me objektiv ekonominë joformale	Hartimi dhe publikimi i raportit

**Në objektivin specifik II.2** është synuar rritja sasiore e përmbushjes vullnetare përmes ngritjes së vetëdijes, raportimit dhe masave ligjore të kufizimit.

Gjatë periudhës raportuese janë paraparë gjithsej dy (2) aktivitete, të cilat nuk janë realizuar. Në draftin e Projekt Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat , është ndryshuar pragu lidhur me transaksionet në mes bizneseve të cilat bëhen në kesh nga 500€ në 300€ , mirëpo ky projektligj ende nuk është aprovuar në Kuvend. Konform kërkesave të ATK-së është zhvilluar

aplikacioni SMPEF për arkat fiskale për përdorimin e të cilit është zhvilluar edhe test serveri për operatorët ekonomikë që do operojnë me të. Po ashtu, është hartuar edhe manuali i përdorimit dhe janë mbajtur trajnime të stafit për përdorimin e këtij sistemi. Ky proces gjendet në fazën finale dhe pritet të vihet në zbatim së shpejti.

**Tabela 7: Sfidat dhe Rekomandimet**

Sfidat	Rekomandimet
Shtyerja e aktiviteteve të parapara për shkak të pandemisë	Finalizimi i këtyre aktiviteteve pas kalimit të rrethanave penguese.

**Në objektivin specifik II.3** është synuar përmirësimi sasior i kapaciteteve institucionale dhe bashkërendimit për zbatim më të mirë të politikave të miratuara.

Gjatë periudhës raportuese janë paraparë gjithsej katërbëdhjetë (14) aktivitete, njëmbëdhjetë (11) apo 78% prej të cilëve janë realizuar, ndërsa tre (3) apo 18% tjetër nuk janë realizuar.

Megjithë avansimin në shkëmbimin elektronik të të dhënave në mes të institucioneve kryesore të vendit si dhe hartimit të formave të reja të komunikimit elektronik me institucionet ndërkombëtare, ende nuk është hartuar një formë standarde për shkëmbimin e të dhënave në mënyrë elektronike. Ndërkaq, ngecje është shënuar edhe në zhvillimin e një moduli për parashikime fiskale për të ardhurat nëpër sektorë. Për shkak të pandemisë, inspektimet në sektorin e ndërtimitarisë dhe OJQ-ve lidhur me shpërlarjen e parasë dhe financimit e terrorizmit kanë qenë më të pakta. Ndërkaq, gjatë periudhës raportuese Njësia për Intelegjencë Financiare ka zhvilluar 17 inspektime tek noterët, me fokus në sektorin e ndërtimitarisë si dhe ka mbajtur trajnime vetëdijësuese për OJQ. ASK në kuadër të Projektit IPA 2017 është duke përpiluar të dhënat për Tabelat Ofruese/Përdoruese (Supply and Use Tables) për periudhën 2013-2015. Projekti përfundon në tetor 2021 dhe të dhënat do të dërgohen në Eurostat. Progres është arritur edhe në kuadër të luftës ndaj evazionit fiskal, ku janë krijuar grupet e përbashkëta në mes të ATK dhe Doganës me qëllim kontrollin e mallrave që kategorizohen me rrezik të lartë të shmangies së taksave dhe janë caktuar detyrat e këtyre grupeve. Rrjedhimisht, janë identifikuar fushat e përbashkëta të bashkëpunimit në mes të dyja institucioneve si dhe janë zhvilluar aktivitete hetimore në terren.

Gjatë periudhës raportuese Policia e Kosovës ka trajtuar 8 raste për veprën penale kontrabandim i mallrave, janë ngritur 7 kallëzime penale kundër 90 personave të dyshuar dhe janë arrestuar 86 persona të dyshuar. Po ashtu, Prokuroria e Kosovës ka zgjidhur raste që përfshijnë 144 persona, ndërsa rastet e pazgjidhura përfshijnë gjithsej 122 persona.

Po ashtu, gjatë vitit 2019 janë iniciuar 350 raste për verifikim të mallrave që shkelin të drejtën intelektuale (IPR). Për këtë periudhë, vlera e mallrave të konfiskuara është 1,935,908 Euro. Ndërsa, janë asgjësuar 541513 njësi të artikujve në vlerë prej 2,318,089 Euro. Ndërkaq, gjatë vitit 2020 janë iniciuar 185 raste për verifikim me dyshime për shkelje të IPR-së si dhe është konfiskuar mall në vlerë prej 603,486.00 Euro. Po ashtu, janë asgjësuar 64255 artikuj në vlerë prej 489,011.00 Euro.

Përkundër situatës së shkaktuar nga pandemia, Dogana e Kosovës ka arritur të realizoj 2778

patrullime me qëllim të luftimit të kontrabandës. Po ashtu Janë realizuar 344 kontrolla pas importuese dhe janë realizuar 189 aktvendime për inkasim në vlerë prej 2,037,534 Euro. Po ashtu, në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të Doganës së Kosovës, në vitin 2019 janë trajnuar 192 oficerë të DZL në trajnime të ndryshme profesionale, ndërsa në vitin 2020 zyrtarët e zbatimit të ligjit i kanë vijuar 4 webinare në fushën e zbatimit të ligjit ku janë trajnuar 52 oficer.

Gjate vitit 2020, në bashkëpunim me institucione ndërkombëtare, ATK ka zhvilluar katër trajnime në fushën e menaxhimit të rrezikut si ne vijim: a) Identifying Tax Fraud, Including Online Trade; b) Fostering Domestic Revenue Mobilization (DRM) through Cooperation; c) Estimating the Tax Gap; d) Rishikimi i planifikimit të kontrollit dhe përdorimi i Modulit të kontrollit.

Për të parandaluar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, posaçërisht në sektorin e ndërtimit dhe patundshmërive, në vitin 2019 NJIF-K ka organizuar dhe mbajtur trajnim për 94 auditorë. Po ashtu, Njësia për Inteligjencë Financiare dhe UNDP në Kosovë kanë organizuar trajnim online për zyrtarët e NJIF-K, BQK, ATK, Doganën, Prokurorët, Hetuesit Policorë, Ministrinë e Drejtësisë, Agjencinë Kundër Korrupsion, zyrtarët e pajtueshmërisë nga sektori privat përfshirë bankat, auditorët, kontabilistët dhe subjektet tjera raportuese. Qëllimi i trajnimit ka qenë përforsimi i regjimit të luftës kundër pastrimit të parave (PP) përmes shkëmbimit të përvojave me ekspertët nga sektori publik dhe privat në Itali. Më tepër se 170 zyrtarë nga sektori publik dhe privat morën pjesë në ditët e trajnimeve.

Po në kuadër të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në periudhën 2019-2020 zyrtarët e NJIF-K kanë marrë pjesë në mbi 40 trajnime vendore dhe ndërkombëtare. Ndërsa, në kuadër të Prokurorisë janë mbajtur dy lloje të trajnimeve për gjithsej 25 zyrtarë.

**Tabela 8: Sfidat dhe Rekomandimet**

Sfidat	Rekomandimet
Krijimi i formave standarde për shkëmbime elektronike	Instrukcioni mbi institucionin udhëheqës gati dhe i raportuar ne Sekretariat
Përmirësimi i kapaciteteve të parashikimeve fiskale për të ardhurat nëpër sektorë	Instalimi i moduleve të reja krahas modelit të programimit fiskal.

Ky raport është rezultat i punës dhe bashkëpunimit ndër-institucional, andaj falënderojmë të gjitha institucionet për kontributin e tyre.